



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 498/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaqi dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie Morina Ajvazi, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik, koalicioni Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHET** e bazuar ankesa Anr.498/2019 e datës 20.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik, koalicioni Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 fletëvotim në Vendvotimin 3051A/01D, të shpallet i pavlefshëm, dhe i njëjti të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar, i publikuar me datë 07.11.2019.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 20.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.498/2019, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 19.11.2019, rreth orës 20:00, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë procesit të rinumërimit të votave në kutinë e votimit 3051A/01D, shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të rregullores Zgjedhore 06/2013. Në kutinë 3051A/01D, në të cilën gjindet fletëvotimi i kontestuar është shënuar shenja "Tik", në katrorin e subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, me nr. 122, mirëpo, jashtë katrorit të subjektit politik JGP, me nr. 123, në anën e djathtë është shënuar një "TIK" tjetër, dhe ky fletëvotim është shpallur i vlefshëm, e që vërehet qartë se votuesi ka shprehur vullnetin politik ose ti votoj dy subjekte politike ose ka shprehë qëndrim në fletëvotim përmes atyre shenjave mbi të cilën e bën qëllimin e votuesit të paqartë, sipas ankuesit një veprim i tillë bie në kundërshtim me nenin 7 par. 2 pika a), b), duke kërkuar nga PZAP-i që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm dhe të obligohet KQZ-QNR, që këtë fletëvotim ta largojë nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar.

Lidhur me pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ankesës i ka bashkangjitur një mostër të fletëvotimit të pavlefshëm sipas Doracakut të KQZ-së, shtojca 8 dhe 7 dhe një kopje të fletëvotimit nr.3051A/01D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit 3051A/01D, nga ana e QNR-së, është shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim, në të cilin votuesi përveç se ka votuar për subjektin politik koalicionin NISMA-AKR-PD, i njëjti në rubrikën nr.123 të subjektit politik JGP ka vendosur shenjën “TIK”, dhe megjithatë QNR-ja me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm dhe të njëjtën të mos e përfshijë në rezultatin përfundimtar zgjedhor të shpallur me 07.10.2019

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit se një fletëvotim i gjetur në kutinë e votimit 3051A/01D, pa të drejtë është shpallur i vlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk e përmbushë asnjërin kriter të vlefshmërisë, andaj i njëjti duhet të llogaritet si i pavlefshëm dhe duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar i publikuar më datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Fletëvotimi i shpallur i pa vlefshëm, të largohet nga rezultati i publikuar përfundimtar i datës: 07.11.2019.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr. 498/2019 më datë 21.11.2019**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***



498  
30514/1010


R KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019  
SKUPËSTINU REPUBLIKE KOSOVO 2019

1 Shtampimi VETEM NJË subjekt i plotë  
Ozmidje SAMO JEDAN po

- 111. PARTIA LIBERALE EGIPTIANE - PLE
- 112. PAK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
- 113. PM/ PARTIA E ASHKALINJEVE PER INTEGRIM - PAI
- 114. STRANKA DEMOKRATISKE AKCIJE - SDA
- 115. PARTIJA KOSOVSkih SRBA - PKS
- 116. MA/ PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK
- 117. POKRET ZA GORA - PG
- 118. NOVA DEMOKRATISKA STRANKA - NDS
- 119. AAK- PSD PSD - KOALICIONI 100% KOSOVE
- 120. SLOBODA
- 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS
- 122. NISMA SOCIAL DEMOKRATE TË ALEANCA KOSOVA E REPARTIA E DREJTËSISE
- 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- 124. V KOALICIJA VAKAT
- 125. FJALA
- 126. LEVIZJA VETËVENDOSJEI
- 127. KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KDTP
- 128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREGK

2 Shtampimi ME SË SHIJATI PRESE kandidati  
Ozmidje NAJVIŠE MET kandidata

1	2	3	4
5	6	7	8
9	10	11	12
13	14	15	16
17	18	19	20
21	22	23	24
25	26	27	28
29	30	31	32
33	34	35	36
37	38	39	40
41	42	43	44
45	46	47	48
49	50	51	52
53	54	55	56
57	58	59	60
61	62	63	64
65	66	67	68
69	70	71	72
73	74	75	76
77	78	79	80
81	82	83	84
85	86	87	88



1 Shtampimi VETEM NJË subjekt i plotë  
Ozmidje SAMO JEDAN po

- 111. PARTIA LIBERAL
- 112. PAK PARTIA DEMOK
- 113. PM/ PARTIA E ASH
- 114. STRANKA D
- 115. PARTIJA M
- 116. MA/ PARTIA D